



BASHKIA MIRDITË

KOMUNIKIM PUBLIK

Në lidhje me pretendimet publike për strukturën organizative të Bashkisë Mirditë, të shpërndara kohët e fundit në rrjetet sociale dhe jo vetëm, të cilat po përhapin informacion të pasaktë dhe po keqinterpretojnë mënyrën e funksionimit të Bashkisë Mirditë, në mbështetje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që u janë dhënë njësisë të vetëqeverisjes vendore, dëshirojmë të sqarojmë opinionin publik si më poshtë vijon:

1. Vendimi Nr. 02. datë 08.01.2024 për strukturën aktuale organizative të Bashkisë Mirditë, është bazuar në VKB nr. 50 datë 15. 12. 2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024” të Bashkisë Mirditë, konfirmuar me shkresën nr.1038/2 të Prefektit të Qarkut Lezhë.

Sipas strukturës organizative të Bashkisë Mirditë, në përmbushje të funksioneve të saj si dhe ato të transferuara, numri i punonjësve të miratuar është 360 punonjës por numri aktual i tyre është 354 punonjës.

Nga sa më sipër theksojmë se në këtë numër janë të përfshirë 170 punonjës, të cilët paguhen si pasojë e transfertës së kushtëzuar të pushtetit qendror si delegim funksionesh pushtetit lokal.

Rrjedhimisht numri i punonjësve, të cilët paguhen nga transfertat e pakushtëzuara dhe të ardhurat e bashkisë Mirditë është $354 - 170 = 184$ punonjës.

2. Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes e krijuar për përmbushjen e funksioneve në infrastrukturë dhe shërbime publike, ka 111 punonjës dhe 2 të punësuar të miratuar me VKB nr. 76, datë 25. 09. 2024, nga fondet e sponsorizuara nga Subjekti “Seka Hydropower”.

3. Gjithashtu me datë 30. 08. 2024 Bashkia Mirditë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit (AKPA) Lezhë, “Për zbatimin e programeve të punëve publike në komunitet, ku si rezultat i kësaj marrëveshjeje janë punësuar 12 punëkërkues të papunë (1 prej tyre ka dhënë dorëheqjen.)

4. Referuar listës që po qarkullon këto ditë në rrjetet sociale, ku janë publikuar emrat e punonjësve të Bashkisë Mirditë së bashku me pagat e tyre, sqarojmë opinionin publik se kjo përbën një shkelje të Ligjit nr. 124/2024 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Këto publikime janë kthyer në një formë presioni dhe intimidimi ndaj punonjësve të Administratës, duke shkaktuar shqetësim tek ata, dëmtuar integritetin e tyre dhe klimën e punës.

Bashkia Mirditë është e hapur ndaj çdo institucioni, organizate të shoqërisë civile, media apo individit për të ndarë informacion mbi aktivitetin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht me Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Kemi zbatuar dhe do të vazhdojmë të zbatojmë me përkushtim parimin e transparencës dhe llogaridhënies në funksion të informimit dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

Të gjitha informacionet institucionale, dokumentet zyrtare, përfshirë organikën, VKM-të që përcaktojnë strukturën e pagave etj. janë të publikuara dhe të aksesueshme në faqen tonë zyrtare. www.bashkiamirdite.gov.al

5. Bashkia Mirditë ka treguar përmirësim të dukshëm në ofrimin e shërbimeve publike dhe realizimin e punëve infrastrukturore, të cilat kanë përfshirë rehabilitimin e rrugëve rurale, sistemime trotuaresh, vendosje të urave, ndriçimin publik, pastrimin, mjedise të sistemuara si dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve.

Këto ndërhyrje kanë përmirësuar dukshëm jetën e përditshme në komunitet..

Duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë territoriale të Bashkisë Mirditë (ndër 5 bashkitë më të mëdha në vend për nga territori), strukturën demografike dhe përhapjen e 7 njësive administrative, ofrimi i shërbimeve vendore në kushte të vështira infrastrukturore mbetet një sfidë.

6. Pavarësisht zhurmës mediatike dhe përpjekjeve për të dëmtuar imazhin institucional, Bashkia Mirditë mbetet e përkushtuar ndaj prioriteteve të saj, duke vijuar punën për:

- investimet në komunitet,
- hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore,
- zhvillimin dhe administrimin e qëndrueshëm të aseteve publike,
- forcimin e kontrollit të territorit,
- si dhe promovimin e turizmit lokal si një burim potencial ekonomik.

Megjithatë, dëshirojmë të nënvizojmë se:

Zhvillimi lokal nuk është dhe nuk mund të jetë rezultat i një institucioni të vetëm. Ai është rezultat i kontributeve të përbashkëta — i bashkëpunimit mes institucioneve, qytetarëve, bizneseve dhe gjithë aktorëve të komunitetit.

Çdo përpjekje për ta paraqitur Bashkinë Mirditë si arenë sulmi, e ndarë nga realiteti, është e pavend dhe dëmton vetë komunitetin tonë.

Rrëshen, më 8 korrik 2025.